Bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, neni 75 dhe VKA nr. 5, datë 14. 08. 2020 "Për shtesa e ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 "Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore" dhe sipas Urdhrit Nr. 8749 Prot., datë 15.09.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore "Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur", Instituti i Sigurimeve Shoqërore, shpall vend të lirë pune për pozicionin:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë

Dega e Përfitimeve/ Sektori i Përfitimeve

1. **Specialistë për Përpunimin e Përfitimeve**

2 (dy) vende pune

Kandidati konkurues :

- Duhet të zotërojnë diplomë Universitare të Nivelit Bachelor ose të barazvlefshëm me të, sipas legjislacionit të Arsimit të Lartë në Shkenca Ekonomike/ Juridike/ Shkencat e Natyrës, dega Matematikë.
- Përparësi kanë studentët e ekselencës si dhe persona që kanë të paktën 2 vjet punë në nivel specialisti në administratë publike/ shërbim civil ose / dhe minimum dy vjet punë në sektorin privat.

Kërkesat e përgjithshme specifike

- Të jenë shtetas shqiptar;
- Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jenë në kushte shëndetësore që lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jenë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tyre të mos jenë marrë masa disiplinore të largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike, që nuk është shënuar, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim & intervista

- Njohuri në fushën e Sigurimeve Shoqërore (Statuti i ISSH, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).
- Njohuri të Rregulloreve Financiare, të Përfitimeve, të Kontributeve dhe për sistemin e informacionit të ISSH;
- Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat";
- Njohuri të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë;
- Njohuri të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale",
- Njohuri të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 **"**Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike";
- Njohuri të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike";

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen :

- vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
- intervista me gojë ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, **deri në 20 pikë**;
- për intervistën me gojë, **deri në 40 pikë**;
- për vlerësimin me shkrim, **deri në 40 pikë**.
- Kandidatët konkurues kualifikohen nëse në total ka fituar **mbi 70 pikë,** nga 100 pikë të mundëshme, gjatë fazës së vlerësimit.

Numri minimal i konkurrentëve, që kalojnë në fazën e vlerësimit të kandidatëve, duhet të jetë jo më pak se tre kandidatë për pozicionin. Në rast mosplotësimi të numrit të domosdoshëm të kandidatëve konkurues në fazën e vlerësimit, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm merr masa për anulimin e procedurës së konkurimit dhe njofton kandidatët.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin është i interesuar.
- Një kopje e jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Raport të aftësisë për punë
- Fotokopje e librezës së punës;
- Certifikatë ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje e Kartës së Identitetit

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 29.09.2025, pranë zyrës së protokoll / sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lart.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e ISSH - së në datën **01.10.2025**, **ora 10:00**

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH - së në datën **03.10.2025, ora 10:00**